

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6812
E hënë, 30 janar 2023
çmimi 0.40

Komunat i kërkojnë ministrisë
pezullimin e vendimit për
rivlerësimin e pronave I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

REAGOJNË OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE: KRYEMINISTRI ANTIAMERIKAN, KOSOVA NUK MUNDET PA MBËSHTETJEN E SHBA-së



Opozita dhe shoqëria civile kanë shprehur shqetësime për qëndrimet e qeverisë Kurti në lidhje me raportet e fundit në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Sipas tyre, kryeministri Kurti

po bën sjellje antiamerikane. Reagimet e tyre vijnë pasi ambasadori i Kosovës në ShBA, Ilir Dugolli, i ka dërguar raport ministres së Jashtme, Donika Gërvalla, të cilën e ka

njoftuar për punën njëvjeçare të ambasadës dhe për mesazhin që ua përcjell institucioneve të vendit, se raportet Kosovë - ShBA nuk janë edhe aq të mira

OPINION

ALBIN KURTI
NUK ËSHTË I
VETMI FAJTOR
PËR KËTË
KATANDISJE F. 6



Milazim KRASNIQI

AKTUALE



OSMANI: TENSIONET NË RAJON
RRISIN MUNDËSINË PËR NDIKIMIN
E FAKTORËVE DESTRUKTIVË F. 2

NJË DELEGACION NGA ULOQINI
TAKOHET ME KURTIN, I SHQETË-
SUAR PËR NDËRHYRJEN E KISHËS
ORTODOKSE SERBE F. 3

EKONOMI



INFLACIONI NË EVROPË PO BIE, POR
ÇMIMET E USHQIMEVE PO RRIEN F. 7

SPORT



LORIANA FITON MEDALJEN E
BRONZTË NË PORTUGALI F. 10

LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN, EURODEPUTETI MANDL: EDHE UNË E KAM HUMBUR DURIMIN I FAQE 3



ARBнора SALIHU ZGJEDHET
KRYETARE E RDK-së I FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani: Tensionet në rajon rrisin mundësinë për ndikimin e faktorëve destruktivë

SHKUP, 29 JANAR - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", shprehu keqardhje për vendimin e Sofjes që ta tërheqë ambasadorin e saj nga Shkupi, duke nënvizuar se kjo ishte një tërheqje e përkohshme pasi, sipas tij, dialogu është mënyra e vetme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Osmani, po ashtu, tha se shfaqja e tensioneve midis Shkupit dhe Sofjes, në kohën

kur ka zhvillime intensive midis Prishtinës dhe Beogradit, rrit mundësinë për ndikimin e faktorëve destruktivë pasi, sipas tij, tani ata kanë më shumë hapësirë për të vepruar. Sipas kryediplomatit maqedonas, Rusia është e interesuar dhe vepron në forma të ndryshme që në rajonin e Ballkanit Perëndimor të ketë krizë të përhershme dhe çështje të hapura pasi, në këtë mënyrë, sipas Osmanit, Moska mund të ndikojë në politikën e brendshme të rajonit.



Ekuipazhet ukrainase të tankeve mbërrin në Britani për stërvitje



LONDËR, 29 JANAR - Ekuipazhet ukrainase të tankeve kanë mbërritur në Britani të Madhe për t'i filluar stërvitjet e tyre, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes e Britanisë më 29 janar dhe kjo vjen vetëm disa ditë pasi Britania dhe vendet e tjera të NATO-s premtuan më shumë

se 130 tanke për Ukrainën. "Mbretëria e Bashkuar do t'i ofrojë Ukrainës tanke Challenger 2 së bashku me vendet partnere globale - duke demonstruar ndërkombëtarisht mbështetjen për Ukrainën", ka njoftuar ministria britanike në "Twitter"

të dielën. Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania ranë dakord javën e kaluar për t'i dërguar Ukrainës tanke Abrams dhe Leopard 2, ndërsa Mbretëria e Bashkuar më herët në janar tha se do t'i dërgojë Kievit 14 tanke Challenger 2.

Gjermania lejoi, gjithashtu, vende të tjera, si Norvegjia dhe Polonia, t'i dërgonin tanket e tyre Leopard 2 të prodhimit gjerman në Ukrainë. Polonia tha se do të sigurojë 60 tanke të tjera për Ukrainën, përveç 14 tankeve Leopard 2 të prodhimit gjerman që ajo ka premtuar tashmë. Autoritetet ukrainase kanë thënë vazhdimisht se atyre u nevojiten 300 tanke, ndërsa përpiqen t'i dëbojnë forcat ruse nga territori i tyre. Rusia ka shumë më shumë tanke se Ukraina, por modelet e tyre janë inferiore në disa aspekte kyçe ndaj modeleve perëndimore. Si Rusia ashtu edhe Ukraina pritet t'i nisin ofensiva në javët e ardhshme, me tanke që pritet të luajnë një rol jetik në ato beteja, thanë ekspertët.

Ndërkohë, luftimet në vijën e frontit mbeten intensive, veçanërisht në rajonin lindor të Donjeckut, me beteja të mëdha në Vuhledar dhe Bahmut, një qytet që është rrafshuar nga bombardimet e përsëritura të artilerisë ruse. Kreu i administratës ushtarake rajonale të Donjeckut, Pavlo Kyrlyenko, tha më 29 janar se katër persona u vranë dhe 17 të tjerë u plagosën në sulmet ruse në Bahmut dhe Kostyantynivka një ditë më parë. Në provincën jugore të Hersonit, autoritetet thanë se sulmet ruse shënjestruan infrastrukturën civile në distriktin Beryslav gjatë 24 orëve të fundit, duke dëmtuar disa shtëpi dhe ndërtesa fermash. Pushtimi rus i Ukrainës ka nisur më 24 shkurt.

Italia nënshkruan marrëveshje miliarda dollarëshe për gazin me Libinë

Romë, 29 janar - Kompania shtetërore e energjisë në Itali, ENI, ka nënshkruar një marrëveshje prej 8 miliardë dollarësh me Korporatën Kombëtare të Naftës së Libisë për të zhvilluar dy fusha libane të gazit në det të hapur, teksa vendet evropiane kërkojnë të shkurtojnë varësinë e tyre nga energjia ruse. ENI do të ndihmojë në zhvillimin e tyre, ndërsa prodhimi pritet të fillojë në vitin 2026, tha kompania më 28 janar. ENI vlerësoi se fushat mund të prodhojnë rreth 7.5 miliardë metra kub gaz në vit ose më shumë se dy të tretat e sasisë që importoi Italia nga Rusia

vitin e kaluar. Shtetet evropiane kanë nxituar të blejnë gaz natyror nga burime joruse, duke përfshirë Afrikën e Veriut, pas pushtimit të Kievit nga Moska në shkurt të vitit 2022. Italia ka qenë konsumatorja e dytë më e madhe e gazit rus në Evropë pas Gjermanisë. Njoftimi i kompanisë ENI erdhi teksa kryeministrja italiane Giorgia Meloni vizitoi Afrikën e Veriut të pasur me energji. Rusia ka qenë furnizuesja më e madhe e Bashkimit Evropian me gaz natyror, duke mbuluar rreth 40 për qind të nevojave të bllokut më 2021. Këtë fuqi e ka përdorur Kremli pas nisjes së luftës në



Ukrainë më 24 shkurt. Përmes uljes së furnizimeve, Rusia ka tentuar ta përçajë unitetin e Perëndimit në

mbështetjen që i ka ofruar Ukrainës pas nisjes së luftës. Eksportet e gazit natyror rus në BE besohet se do të

zvogëlohen për gati 60 miliardë metra kub më 2023 në krahasim me 140 miliardë metra kub vitin e kaluar dhe gati 200 miliardë metra kub në nivelet para pandemisë së koronavirusit. Pavarësisht se marrëdhëniet në mes të Moskës dhe Perëndimit janë më të këqijat në dekada, Rusia ende e furnizon BE-në me gaz përmes gazsjellësve që kalojnë nëpër Ukrainë dhe Turqi. Megjithatë, sipas ekspertëve, eksportet mund të zvogëlohen edhe më shumë sesa tani, apo edhe të ndalen tërësisht më 2023, duke detyruar Evropën që të gjerë mënyra për gaz në një botë me opsione të limituara.

Krasniqi: Kosova është në ditët më të vështira që nga çlirimi

PRISHTINË, 29 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka vlerësuar se Kosova është në ditët më të vështira që nga çlirimi. Sipas tij, vendi është në një depresion me njerëzit të cilët presin para ambasadave për një vizë për t'u larguar. "Jeni dëshmitarë se aktualisht

Kosova është në ditët më të vështira të saj që nga çlirimi i vendit. Ekonomia e vendit tonë nuk po zhvillohet, shtetësia jonë po kontestohet, lufta jonë për liri po gjykohet, ndërsa qeveria jonë nuk ka zgjidhje për asnjë nga krizat e njëpasnjëshme që i ka prodhuar vetë dhe çka ka

sjellë kjo gjendje sot, një frymë depresioni. Familjet janë në krizë sociale, puna është e pamjaftueshme dhe perspektiva shihet duke pritur për një vizë në ambasada të huaja. Gjendja është e rëndë", ka thënë Krasniqi gjatë Konventës VII të Rinisë Demokratike të dielën.



Liberalizimi i vizave për Kosovën, eurodeputeti Mandl: Edhe unë e kam humbur durimin

PRISHTINË, 29 JANAR - Eurodeputeti austriak Lukas Mandl gjatë një vizite studimore në Kosovë mbajti edhe një konferencë me gazetarë. Mandl tha se edhe vetë ai ka humbur durimin për vonesat që po i bëhen Kosovës për mosliberalizim të vizave, ndërsa theksoi se pret që kjo të bëhet sa më parë. "Presim me padurim që të hyjë në funksion liberalizimi i vizave nga 1 janari i vitit 2024. Kemi parë që ky proces është shtyrë disa herë, prandaj ne do të kujdesemi që ky proces të realizohet. Është vonuar e shtyrë shumë, madje edhe unë e kam humbur durimin për këto vonesa", tha ai.

Ndërsa parlamentari tjetër austriak Helmut Brandstatter tha se duhet gjetur një zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë, por edhe që pesë shtetet e Bashkimit Evropian ta njohin Kosovën. "Duhet të ballafaqoheni me Serbinë dhe të gjendet një zgjidhje, gjithashtu duhet të gjendet një zgjidhje me pesë shtetet e tjera të BE-së që ta njohin Kosovën si vend normal në Evropë", u shpreh

Brandstatter.

E asamblisti në Parlamentin e Vjenës, Hannes Taborsky, tha se Kosovën e pret një e ardhme në mesin e shteteve të BE-së. Eurodeputeti Lukas Mandl është nderuar me çmimin "Doctor Honoris Causa" nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan. Titulli i nderit i është dhënë me këtë motivacion: Për kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve njerëzore, në mbështetje dhe konsolidimin e paqes në Kosovë, në rajon dhe me gjerë; Për kontribut në proceset shtetformuese të Republikës së Kosovës; Për kontribut në avokimin e kauzës së Republikës së Kosovës në Parlamentin Evropian, në Këshillin e Evropës dhe në Bashkimin Evropian, në përgjithësi; Për mbështetje të pakursyer dhe avokim për njohjen ndërkombëtare të Republikës së Kosovës; Për përpjekjet e vazhdueshme si raportues për Republikën e Kosovës në Parlamentin Evropian dhe në Partinë Popullore Evropiane (EPP); Për



kontribut në themelimin e Kosovare dhe Për kontribut në përhapjen e të vërtetës së Shoqatës së Miqësisë Austriako-fushën e kulturës e të medias për Kosovës.

Një delegacion nga Ulqini takohet me Kurtin, shpreh shqetësim për ndërhyrjen e Kishës Ortodokse Serbe

PRISHTINË, 29 JANAR - Deputeti shqiptar në Malin e Zi dhe kryetar i partisë Forca e Re Demokratike, Genc Nimanbegu, ka shprehur në Kosovë shqetësimin për ndërhyrjet e Kishës Ortodokse Serbe në jetën politike e institucionale të Malit të Zi. Nimanbegu këtë e ka theksuar në zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj partie, njëherësh kryeministër, Albin Kurti. Në takim ishin të pranishëm edhe nënkryetarja e dytë e LV-së, Mrika Limani Myrtaj, sekretari organizativ Alim Rama dhe sekretari për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Hajrulla Çeku. Ndërsa Nimanbegu ishte i shoqëruar nga Ardian Mavriqi, sekretar i përgjithshëm, aktualisht kryetar i Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe nënkryetarët e partisë: Ilir Çapuni dhe Arbin Çapriqi. LV-ja ka njoftuar se në takim është thënë se kjo kishë ka tensionuar raportet etnike në Malin e Zi.



"Gjatë takimit kryeministri Kurti i njoftoi përfaqësuesit e partisë shqiptare nga Mali i Zi për situatën politike dhe ekonomike në vend. Në kuadër të diskutimit u theksuan edhe marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me Malin e Zi me ç'rast u përmend edhe ndërtimi i rrugëve Pejë - Rozhajë dhe Deçan - Plavë çka do ta lehtësojë qarkullimin e qytetarëve dhe ta forcojë lidhjen ekonomike dhe tregtare. Në anën tjetër, përfaqësuesit nga Mali i Zi njoftuan për situatën politike atje, me theks të veçantë ndërhyrjen e Kishës Ortodokse Serbe në jetën politike e institucionale, çka ka tensionuar edhe më shumë raportet etnike dhe ndërhyrjet e Serbisë në shtetin e Malit të Zi", thuhet në njoftimin për medie të LV-së.

Në fund thuhet se pjesë e diskutimeve ishte edhe bashkëpunimi në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore në mes të dy vendeve.



Reagojnë opozita dhe shoqëria civile: Kryeministri antiamerikan, Kosova nuk mundet pa mbështetjen e ShBA-së

Opozita dhe shoqëria civile janë shprehur të brengosura me qëndrimet e qeverisë Kurti në lidhje me raportet e fundit në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Sipas tyre, kryeministri Kurti po bën sjellje antiamerikane, duke theksuar se vendi ynë nuk mund të ecë pa mbështetjen e ShBA-së. Këto reagime vijnë pasi ambasadori i Kosovës në ShBA, Ilir Dugolli, i ka dërguar raport ministres së Jashtme, Donika Gërvalla, të cilën e ka njoftuar për punën njëvjeçare të ambasadës dhe për mesazhin që ua përcjell institucioneve të vendit se raportet Kosovë - ShBA nuk janë edhe aq të mira

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - "Me trajtim nga shteti nikoqir që është larg më brutal se që mund të perceptohet në kryeqendër", kështu i ka raportuar ambasadori i Kosovës në ShBA, Ilir Dugolli, ministres së Jashtme, Donika Gërvalla, në raportin e punës për një vit në krye të kësaj ambasade në lidhje me raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së të cilin e ka siguruar gazeta "Nacionale".

Ky raport i ambasadorit Dugolli i forcon deklaratimet e fundit nga opozita dhe nga një pjesë e shoqërisë civile, se raportet mes ShBA-së dhe Kosovës janë përkeqësuar me ardhjen e Albin Kurtit kryeministër.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka theksuar se kjo është fotografia e marrëdhënieve në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës që sot drejtohet nga Vjosa Osmani e Albin Kurti. "Trajtim nga shteti

nikoqir që është larg më brutal se që mund të perceptohet". Kjo është fotografia e marrëdhënieve në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës tonë, që sot drejtohet nga Vjosa Osmani e Albin Kurti. Ky është i vetmi tregim që s'kemi besuar e pritur se do ta dëgjojmë ndonjëherë. Por ja që po ndodh e po shpalolet përpara syve tanë", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

Ai ka thënë se degradimi i raporteve me ShBA-në për Kosovën nënkupton një gjë të vetme: rrugën pa krye në drejtim të gabuar historik, politik e shtetëror. "Për këtë gjendje s'ka koment. Ka vetëm adresë dhe autorë: Vjosa Osmani dhe Albin Kurti", ka pohuar Tahiri.

"Një kryeministër antiamerikan nuk mund t'i kryejë detyrat kushtetuese", kështu thotë analisti politik Halil Matoshi. "Kurti më në fund e pranoi me gojë të vet se ka përplasje me amerikanët! 'Amelika. Amelika'

nuk paskësh qenë vetëm shtrembërim cinik i emrit të shtetit sponsor të lirisë së Kosovës nga vetë ai, por mëshefje e karshillëkut të tij me 'hegemoninë qëllimpirë' (Habermas), ShBA-në", ka theksuar Matoshi.

Sipas tij, Kurti e hapi 'Kutinë e Pandorës' kur tha: "Amerikanët nuk më ftuan në takim për Asociacionin!" "E liderin që e izolojnë amerikanët, do të duhej t'ia kthenin kurrizin edhe kosovarët. Porse Kurti në masë të madhe ka arritur t'ua tjetërsojë realitetin atyre, duke u dhënë për këmbim një realitet paralel virtual që shtetin e trajton si diçka personale, madje ai i ka personalizuar edhe raportet me presidentin serbi Aleksandar Vuçiq dhe me aleatët e Kosovës!? Prandaj ai duhet të ndalet sot. Kryeministri Kurti e di me saktësi se presionin ndërkombëtar që ka ra mbi të e kanë përjetuar të gjithë paraardhësit e tij. Porse mban qëndrim të padrejtë dhe abuziv

ndaj tyre. Tashti, i izoluar nga aleatët e Kosovës, Albin Kurti, i mbushur mlllef, po bëhet i rrezikshëm, madje perëndimorët po e cilësojnë si një egomaniak kokëfortë", ka shkruar Matoshi në "Facebook". Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Avdi F. Smajllaj, ka theksuar se shteti ynë është krijuar, është duke u konsoliduar ndërkombëtarisht falë mbështetjes së ShBA-së. Ai thotë se mbështetja e ShBA-së është e domosdoshme për shtetin tonë. "Institucionet tona duhet ta refuzojnë asociacionin që e dëmton funksionimin dhe qëndrueshmërinë e shtetit në bashkëpunim me ShBA-në. Qasjet e tjera refuzuese të asociacionit, sidomos ato në frymën antiamerikane, janë të dëmshme dhe të paqëndrueshme, të llojit të krekosjes se do t'i heqim vetë barrikatad në veri të para disa javëve. Shteti ynë mundet pa secilën parti politike e pa secilin politikan/e, por nuk mundet pa

Hoti: Jemi në qorrrokak, ka kërkesë për themelimin e menjëhershëm të Asociacionit

PRISHTINË, 29 JANAR - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se Kosova gjendet në pozitë të pafavorshme në dialog me Serbinë për shkak të veprimeve të pamatura të Kurtit. Sipas tij, vendi tani është në qorrrokak dhe kërkesa e partnerëve ndërkombëtarë është që të themelohet menjëherë Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

Hoti në një intervistë për "KosovaPress" tha se qeveria e tij pati lënë një kornizë të dialogut që në qëllim ka pasur njohjen reciproke, por veprimet e Kurtit e kthyen pas këtë proces. "Besoj se qasja e gabuar e kësaj qeverie qysh në fillim e ka sjellë këtë situatë. Tash kërkesa e partnerëve tanë ndërkombëtarë është për të themeluar menjëherë Asociacionin. Në

qeverinë paraprake ne e patëm dakordur një kornizë të dialogut me partnerë tanë ndërkombëtarë që nuk i prekin këto tema dhe nuk hynë edhe temat e integritetit territorial, të sovranitetit, që marrëveshja përfundimtare duhet të jetë për normalizim dhe njohje reciproke, që duhet të jetë marrëveshje brenda Kushtetutës së Kosovës dhe që nuk

dakordohemi për asgjë derisa nuk dakordohemi për të gjitha. Çfarë bëri kjo qeveri kur e mori pushtetin? Hoqi dorë nga ajo kornizë e dialogut dhe doli me disa pika që u kthyen para një shekulli e gjysmë, dhe e futi vendin dhe veten në qorrrokak", ka theksuar Hoti. Hoti u shpreh se Kosova është në pozitën më të pafavorshme për të dialoguar për shkak të

vendimeve që çuan në tensionimin e situatës në veri dhe tërheqjen e serbëve nga institucionet e Republikës. "Rruga më e mirë është krijimi i konsensusit politik brenda vendit dhe koordinimi i ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë, në veçanti me ShBA-në, të mos krijohen probleme të panevojshme në terren", është shprehur Hoti.



mbështetjen e ShBA-së", ka shkruar Smajllaj në "Facebook". Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës, Ismet Kryeziu, ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit dhe raportet me Amerikën. "Sa respekt, dashuri e përkushtim po tregoni për Martin Berishajn. Me pas treguar veç pak për politikën amerikane, shumë më mirë do t'i kishte punët Republika e Kosovës", ka shkruar në "Facebook" Kryeziu.

Ai ka thënë se ekzistojnë disa praktika të njohura përmes të cilave luftohen OJQ-të, duke tentuar t'u dëmtohet reputacioni publik i tyre. "Duke i akuzuar si jo patriotë, tradhtarë dhe të angazhuar kundër

interesave të shtetit, duke i akuzuar për mbështetje financiare nga shtete të huaja dhe si agjentë të këtyre shteteve, duke i ngacmuar dhe duke tentuar t'ua ekspozoni jetën e tyre private, duke i akuzuar dhe sajuar lidhje e interesa me parti të caktuara kundër demokracisë, duke i ndjekur dhe i hetuar për vepra penale ose taksa mbi akuzat të sajuara nga pushteti etj.", ka thënë ai. Ai ka thënë se jo qeveria zyrtarisht, por partia në pushtet dhe partizanët e saj prej kohësh kanë sajuar armiqet e Kosovës. Kryeziu ka treguar se Viktor Urban, kryeministri hungarez, bëri ligje pothuajse të njëjta me ato të Rusisë përmes të cilave

reduktoi hapësirën qytetare, kryesisht angazhimin e OJQ-ve dhe njerëzve që përkonin në këto organizata. "Në vitin 2014, pas fitores së tij të dytë, pothuajse të pakonkurrentë, ai identifikoi armiqet e tij kryesorë si 'liberalët' nga Perëndimi dhe i përmendi në mënyrë të drejtpërdrejtë, Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe OJQ-të si agjentë të huaj. Madje ai bëri ligje dhe rregulla që secili aktivitet, raport, analizë e OJQ-ve, që nuk janë instrumente të kontrolluara nga pushteti i tij, janë të mbështetura nga donacione të këtyre shteteve, të shkruajnë se janë të mbështetura nga fonde të huaja. Në të kundërtën do të

ndiqen dhe dënohen. Pra të vetëshkruajnë se janë tradhtarë dhe agjentë të shteteve të huaja. Te ne ende s'janë krijuar këto ligje e rregulla, por ka herë është investuar në këtë mendësi. Jo qeveria zyrtarisht, por partia në pushtet dhe partizanët e saj prej kohësh kanë sajuar armiqet e Kosovës. OJQ-të tradhtarë e politikë amerikane edhe atë të BE-së, armiqësore e kundër interesave të Republikës së Kosovës?!", ka shkruar Kryeziu. Edhe profesori universitar Milazim Krasniqi ka reaguar kur përplasjet mes qeverisë Kurti dhe Amerikës janë shtuar më shumë. Krasniqi ka shkruar në "Facebook" se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

NATO-ja Kosovën mund ta mbajnë nën kontroll pa pasur partneritet me Qeverinë e Kosovës. Ai ka thënë se kjo mundësohet me marrëveshjen ushtarake-teknike të 9 qershorit 1999 dhe Rezolutës 1244. "ShBA-të, përkatësisht NATO-ja, Kosovën mund ta mbajnë nën kontroll dhe në sferën e vet edhe pa partneritet me qeverinë e Kosovës. Këtë gjë ua mundëson në mënyrë absolute Marrëveshja Ushtarake-Teknike e 9 qershorit 1999 dhe Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të 10 qershorit 1999, të cilat nuk e kanë asnjë afatizim dhe faktikisht asnjë kufizim të imponimit të vullnetit të pushtetit", ka shkruar Krasniqi.

Albin Kurti nuk është i vetmi fajtor për këtë katandisje



Milazim KRASNIQI

Më së lehti është të thuhet se Albin Kurti ka faj për përkeqësimin e raporteve të Kosovës me ShBA-në. E vërteta është që Kurti e ka një pjesë të fajit për këtë përkeqësim. Por, e vërteta është që Kurti e ka trashëguar këtë tendencë të përkeqësimit të besimit me amerikanët nga paraardhësit e vet në qeveri, nga i pari tek i mbarami. Ja një tabelë: - dhuna politike menjëherë pas çlirimit, ndaj serbëve lokalë po edhe ndaj aktivistëve politikë, ishte një lloj shoku për amerikanët. Si

mund të bëheshin dhunues, ata që ishin deri dje viktimë? Tentuan ta ndalnin atë tendencë me krijimin e një përfaqësie të përbashkët, (Ollbrajt dhe Hill) por ajo u refuzua nga njëra palë jona dhe gjendja rrëshqiti edhe më fort drejt një lloj anarkie politike e të sigurisë. - Trazirat e marsit 2004 shënuan krisje edhe më të madhe të besimit në vizionin, guximin dhe ndershmërinë e përfaqësuesve politikë të Kosovës. - Privatizimet shumë herë banditeske dhe korrupsioni galopant, shkaktuan hutim dhe zhgënjim tek amerikanët. - Pas pavarësimit dolën ide minuese ndaj pavarësisë së Kosovës-bashkimi me Shqipërinë dhe shkëmbimi i territoreve me Serbinë. - U refuzua me dhunë demarkacioni me Malin e Zi, edhe pse miratimi ishte interes strategjik i NATO-s, sepse ishte

parakusht i anëtarësimit të Malit të Zi në NATO. - U sulmuan brutalisht institucionet. Në një rast u sulmua edhe ambasadorja amerikane. - U tentua të zhbëhej Gjykata Speciale. - Nuk pati asnjë qeveri vullnet të formohej Bashkësia e Komunave me kohë e me terma më të butë, se sa këta që janë sot më qarkullim. - U bë një lojë pa asnjë kuptim me taksën 100%, në kundërshtim me rekomandimet e qarta amerikane, që ajo të hiqej. Votuesit e zhgënjyer dhe të hutuar, vunë bast me tërë shumën në Kurtin, duke e bërë jo vetëm kryeministër me fuqi të madhe të votës po edhe tabelë qitjeje. I ekzaltuar gabimisht nga ai rol, Kurti në vend që të tregonte maturi, tregoi arrogancë të pafrenuar. Gabimin fatal e bëri me problemin e targave, ku tregoi

aventurizëm e jo liderizëm. Dhe ashtu provokoi ortekun e Serbisë ndaj qeverisë së tij. Për shkak të ndryshimeve gjeopolitike që solli agresioni rus në Ukrainë, tash Serbia po ledhatohet nga Perëndimi, që të shkëputet nga influenza ruse, prandaj orteku ndaj Kurtit nuk është vetëm i Serbisë, po edhe i Perëndimit. Ky ortek ka rrezik ta dëmtojë jo vetëm Kurtin, po edhe Kosovën. Ama, përgatitja e këtij orteku ka kohë të gjatë që është përgatitur. Është ortek ndaj një elite hipokrite, abuzuese e të paafte, po si duket edhe ndaj një shteti që nuk po do të bëhet vend. Në instancë të fundit, Kurti e përfaqëson në mënyrë legjitime atë shumicë, e cila nuk po dëshmon me veprime qytetare se e duan Kosovën si shtet. Ne duhet ta kemi të qartë edhe këtë gjë të fundit: ShBA

përkatësisht NATO-ja Kosovën mund ta mbajnë nën kontroll dhe në sferën e vet edhe pa partneritet me qeveritë e Kosovës. Këtë gjë ua mundëson në mënyrë absolute Marrëveshja Ushtarake-Teknike e 9 qershorit 1999 dhe rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit e 10 qershorit 1999, të cilat nuk e kanë asnjë afatizim dhe faktikisht asnjë kufizim të imponimit të vullnetit e pushtetit. Fatkeqësisht, politikanët tanë për gjithë këto vite nuk e kanë kuptuar qartë këtë gjendje vasale të Kosovës, e cila më shumë është problem i sigurisë se sa i demokracisë. Shumë prej tyre, duke përfshirë këtu edhe Albin Kurtin, kanë tentuar të sillen si gjoja politikan sovran, (edhe në pabesi ndaj ShBA-së) duke qenë shteti ynë de jure dhe de facto shtet klient e jo shtet sovran.

Arbnora Salihu zgjedhet kryetare e RDK-së

PRISHTINË, 29 JANAR - Arbnora Salihu është zgjedhur kryetare e Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK) në Konventën e Shtatë Zgjedhore. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se suksesi i këtij procesi zgjedhor, inovativ në shume aspekte, të digjitalizuar në secilën fazë e të finalizuar me votim elektronik, ku mbi 50 për qind e anëtarëve të Këshillit Drejtues janë zgjedhur vajza, pa kuotë, në përputhje me vizionin e partisë 50/50 për barazi gjinore, është një momentum i shënuar për PDK-në. "Kjo frymë e re, ky cikël i ri politik që nisi sot në Rininë Demokratike të Kosovës, do ta ketë mbështetjen time të plotë në veprimtarinë dhe

vizionin e tyre për të ardhmen që dëshirojnë. 'Ti Ki Za', përtej sloganit, është një thirrje për të rinjtë dhe të rejtat e vendit tonë që të marrin përgjegjësi, të bashkohen, ta kanalizojnë formimin e tyre intelektual dhe energjinë e pashtershme në transformimin e komunitetit, lagjeve dhe qyteteve të shtetit tonë", ka thënë Krasniqi. Ai ka thënë se duke qenë ky misioni i tyre, zëri i rinisë është çelësi për ta fituar këtë betejë me kohën. "Kosovën do ta kthejmë në vend ku jetohet me dinjitet, ku zëri i të rinjve nuk do të heshtet kurrë dhe i cili ka një adresë kryesore - Partinë Demokratike të Kosovës", ka deklaruar Krasniqi.



Konkursi për policë në veri, PK-ja inkurajon qytetarët e të gjitha komuniteteve pakicë të aplikojnë

PRISHTINË, 19 JANAR - Policia e Kosovës më 4 janar kishte shpallur konkurs për pranimin e zyrtarëve policorë nga radhët e komunitetit serb, boshnjak, turq, goran, rom, ashkali, egjiptas, kroat, malazez dhe maqedonas. Përmes një njoftimi, Polica ka bërë me dije se vendi i punës do të jetë Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Veriut.

Konkursi në fjalë ishte paraparë të mbetej i hapur deri më 26 janar, mirëpo në po të njëjtën ditë nga ana e policisë ishte njoftuar se afati për aplikim do të zgjatej edhe për 10 ditë të tjera. Për këtë konkurs, që do të jetë i hapur deri më 10 shkurt 2023, policia të dielën ka lëshuar një njoftim, me të cilin ka bërë me dije se është duke vazhduar kampanja sensibilizuese për

konkursin e hapur për komunitetet pakicë. "Policia e Kosovës, përmes videomesazheve, fushatave sensibilizuese dhe takimeve zyrtare që po mbahen në të gjitha rajonet, vazhdon t'i inkurajojë dhe ftojë qytetarët e të gjitha komuniteteve pakicë që të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e Policisë së Kosovës", thuhet në njoftim.



AAK-ja: Të ndalen mashtrimet, qeveria ta shfuqizojë vendimin për rritje të tatimit në pronë

PRISHTINË, 29 JANAR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar të shfuqizohet aplikimi i rivlerësimit të fundit dhe faturat për vitin 2023 të llogariten sipas vlerësimeve të bëra para vitit 2022. "Të ndalen mashtrimet, qeveria ta shfuqizojë vendimin për rritje të tatimit në pronë. Vendimi i Ministrisë së Financave për rritjen e tatimit në pronë ka

goditur direkt xhepin e qytetarëve në këtë kohë kur çmimet për secilin produkt janë dyfishuar. Në mungesë të veprimeve serioze në shërbim të rritjes së mirëqenies socio-ekonomike, qeveria paska vendosur që përmes kuvendeve komunale të vazhdojë mashtrimin me propozimin për faljen e tatimit në pronë për 100 euro. Kjo nismë është antiligjore,

sepse Ligji për Tatimin në Pronë është i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe vetëm Kuvendi ka të drejtë ta ndryshojë ose t'i falë borxhet e tatimit në pronë. Kjo qasje mashtruese duhet të ndalet! Të shfuqizohet aplikimi i rivlerësimit të fundit dhe faturat për vitin 2023 të llogariten sipas vlerësimeve të bëra para vitit 2022!", është thënë në reagimin e AAK-së.



Komunat i kërkojnë ministrisë pezullimin e vendimit për rivlerësimin e pronave



PRISHTINË, 29 JANAR - Bordi i Asociacionit i Komunave të Kosovës (AKK) i ka kërkuar Ministrisë së Financave, Transfereve dhe Punës (MFTP), që vendimi për rivlerësimin e pronave të pezullohet dhe që qytetarët e Kosovës ta paguajnë vlerën e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023 ashtu siç e kanë paguar në vitin 2022. Kështu thuhet në njoftimin për medie të AKK-së, ku përmenden edhe arsyet që thuhet se e kanë shtyrë bordin

për ta shtruar këtë kërkesë. "Rrethana të vështira ekonomike për qytetarin, shkalla e inflacionit është dyshifrore, shtrenjtim të çmimeve të produkteve bazë dhe produkteve të tjera, nivel i pagave i pandryshuar për vite të tëra dhe ndikim i drejtpërdrejtë në rëndimin e shportës për qytetarin", thuhet në njoftim.

Tatimi në pronë është taksë vjetore komunale dhe përcaktohet nga shumëzimi i

vlerës së pronës me normën tatimore. Normat tatimore vendosen nga komunat përkatëse, ndërsa vlerësimi i pronës bëhet nga ministria. Kjo normë është 0.15 për qind e vlerës së përgjithshme.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë të premten se rritja e tatimit në pronë nuk ka qenë përgjegjësi e këtij institucioni e as e qeverisë aktuale. Murati ka thënë në një konferencë për medie se faturat e tatimit në pronë për

këtë vit janë më të larta pasi ka hyrë në fuqi tatimi 100 për qind për tokat dhe është bërë vlerësimi i pronave rezidenciale si dhe shkallës tatimore.

Murati ka thënë se meqë kjo rritje ka shkaktuar pakënaqësi te qytetarët, Ministria e Financave dhe Qeveria e Kosovës janë të gatshme t'i dëgjojnë propozimet e komunave për ta ulur apo për të marrë përsipër shlyerjen e një pjese të tatimit në pronë

për qytetarët.

Bordi i AAK-së, po ashtu, kërkon të ketë takime dhe "konsulta të mirëfillta me komunat" në mënyrë që të gjenden mënyra më të mira për një rivlerësim të pronës.

Çështja e tatimit në pronë është bërë temë diskutimi pas reagimeve të qytetarëve në rrjetet sociale, të cilët kanë treguar se faturat e tyre të tatimit në pronë janë rritur mbi 50 për qind në krahasim me të kaluarën.

Inflacioni në Evropë po bie, por çmimet e ushqimeve po rriten

Prishtinë, 29 janar - Çmimet e ushqimeve kanë vijuar të rriten në të gjithë Evropën pavarësisht se inflacioni ra për të dytin muaj radhazi. Sipas të dhënave të Zyrës Evropiane të Statistikave, gjatë muajit dhjetor 2022 inflacioni i çmimeve të ushqimeve në BE ishte 18.2 për qind dhe 16.2 për qind në Eurozonë, një rënie e lehtë në krahasim me nëntorin 2022. Por çmimet e disa produkteve ushqimore bazë, si sheqeri, djathi, vezët, vajrat dhe yndyrat janë ende në rritje.

Rritje më të lartë u regjistrua në Hungari për rreth 50 për qind, ndjekur nga Lituania me 33.5 për qind dhe me 30.8 për qind nga Estonia. Ndryshimet më të vogla të çmimeve u regjistruan në Luksemburg me 11.1 për qind dhe Qipro 12.2 për qind. Gjashtë kategoritë e ushqimeve ku u regjistruan rritjet më të ndjeshme në vendet e BE-së ishin qumështi i freskët, vezët, sheqeri, vaji dhe yndyrat, gjalpi dhe vajrat e tjera

ushqimore, që sillen nga 30.2 për qind në 56.6 për qind mesatarisht.

Çmimet e sheqerit u dyfishuan në Estoni, u rritën 98.9 për qind në Çeki dhe 87.4 për qind në Poloni. Në Suedi, Danimarkë dhe Luksemburg ndryshimi i çmimit ishte rreth 10 për qind.

Një tjetër produkt nga shporta ushqimore, vezët, çmimet e të cilave u rritën nga 14.8 për qind në Luksemburg në 92.5 për qind në Çeki, ndërsa mesatarja e BE-së ishte 30 për qind.



Iu dha lamtumira atdhetarit, ish-luftëtarit të UÇK-së, Azem Makolli



PRISHTINË, 29 JANAR - Familjarë, miq, bashkëveprimtarë, ish-luftëtarë të UÇK-së, i kanë dhënë dje (e shtunë) lamtumirën e fundit atdhetarit Azem Makolli në varrezat e qytetit në Prishtinë, i cili ka ndërruar jetë dy ditë më parë. Azem Makolli, sikurse edhe të parët e fisit të tij, ishin të brumosur me ide atdhetare e lirishtetë dhe kurrë nuk kishte reshtur së kundërshtuari të huajin në trojet tona.

Idealin e tij çlirimtar e përforcoi edhe më shumë gjatë jetës së tij nëpër burgjet e rënda jugosllave, ku kishte pasur rastin të njohë shumë patriotë e intelektualë të burgosur, si heroi Shaban Shala, Hazir Shala, Kadri Halimi, Adem Demaçi etj. Pas daljes nga burgu ai ka vazhduar komunikimin dhe veprimtarinë çlirimtare si me pjesëtarët e familjes ashtu edhe me shokët që i kishte njohur nëpër burgje, kurse në vitin 1998, ndonëse në moshë të shtyrë, Azem Makolli rreshtohet në radhët e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës. Historia e tij sa ishte e dhimbshme, ishte edhe lavdishme. Ai ishte një figurë që u këndua edhe nga rapsodia shqiptare për heroizmin e treguar në rininë e tij të hershme në rajonin e Gollakut. Veprimtari Ramadan Avdiu me një fjalë rasti para të pranishmëve ka theksuar se sot po ndahen fizikisht nga më i vjetri pjesëtar i oxhakut të familjes Makolli, Azemit, jeta e të cilit ishte sinonim i shqiptarit të okupuar nga pushtuesit serbë. "Të nderuar familjarë, miq, bashkëvujtës, bashkëveprimtarë e bashkëluftëtarë të Azem Makollit. Edhe ndarja është pjesë e jetës, por është pjesa më e dhimbshme e saj. Sot po ndahemi fizikisht nga më i vjetri pjesëtar i oxhakut të familjes Makolli, Azemit, jeta e të cilit ishte sinonim i shqiptarit të okupuar nga pushtuesit serb. Ai e kaloi gjithë jetën e tij i ndikuar thellë nga trauma që e kishte përjetuar si fëmijë pesëvjeçar në shtëpinë e tij në Herticë, kur

serbët, të nxitur nga pushteti okupues, të prirë nga një kriminel në mënyrë barbare, ia vrasin gjyshin Brahimin. Ndonëse fëmijë Azemi asnjëherë nuk qëndroi i qetë, derisa arriti të hakmerret dhe ta vrasë kriminelin që kishte vrarë gjyshin e tij dhe dhjetëra shqiptarë të tjerë", ka thënë Avdiu, duke shtuar se Azemi sot po bashkohet me gjyshin e tij Barahimin, vëllanë Shasivarin dhe të parët e tij me të cilët tashmë prehet në paqe. "Rrethanat nëpër të cilat ka kaluar jetën përplot me krajata, persekutime, ndjekje e rreziqe kanë bërë që ai të krijojë një përvojë të begatshme jetësore, të cilën në vazhdimësi është përpjekur ta bartë edhe te të rinjtë duke i porositur ata t'i ruajnë frytet e sakrificave dhe të luftës, që ta duan punën, të mirën, dijen, ta duan familjen dhe atdheun. Azemi iu bashkua gjyshit të tij, Barahimit, vëllait Shasivarit dhe të parëve të tij, me të cilët tashmë prehet në paqe. Në emër të shokëve, bashkëveprimtarëve e

Mavraj përkujton me pietet Azem Makollin

Prishtinë, 29 janar - Veprimtari dhe lideri i Lëvizjes Studentore i '97-s, Muhamet Mavraj, e ka përkujtuar, pas ndarjes nga jeta, patriotin dhe atdhetarin Azem Makolli (Hertica). Mavraj ka shkruar në "Facebook" se, përveç si çlirimtar në luftën e fundit, baca Azem i ka edhe tri vepra monumentale për në atë botë. "Paska kaluar andej baca Azem Makolli (Hertica). Këndohet në këngë moti. Përveç si çlirimtar në luftën e fundit, edhe tri vepra

monumentale i ka për atë botë: 1. Vrau në rini një kasap serb; 2. Qëndroi si shkëmb në burgjet më të rënda që imagjinohen në ato kohëra; 3. Dera e tij u dha konak e mbrojtje të gjitha gjeneratave patriotike, deri tek ajo që e pashë vetë, përfshirë Bacën Adem në luftë e në paqe! Lamtumirë, o shqiptar prej guri! Të fala Bacës, Shasivarit (Qalit) dhe të gjithë shokëve nga mbarë trojet! Përgjithmonë Lavdi!", ka shkruar Mavraj në "Facebook".

Muhamet Mavraj
January 27 at 4:26 AM · 🌐

Paska kaluar andej baca Azem Makolli (Hertica). Këndohet në këngë moti.

Përveç si çlirimtar në luftën e fundit, edhe tri vepra monumentale i ka për atë botë:

- 1-Vrau në rini një kasap serb;
- 2-Qëndroi si shkëmb në burgjet më të rënda që imagjinohen në ato kohëra;
- 3- Dera e tij u dha konak e mbrojtje të gjitha gjeneratave patriotike, deri tek ajo që e pashë vetë, përfshirë Bacën Adem në luftë e në paqe!

Lamtumirë, o shqiptar prej guri!
Të fala Bacës, Shasivarit (Qalit) dhe të gjithë shokëve nga mbarë trojet!
Përgjithmonë Lavdi!



bashkëluftëtarëve dua të shprehim ngushëllimet dhe i shprehim ngushëllimet tona më të thella", ka thënë Ramadan Avdiu.



KAMENICA NJË SKAJ I ATDHEUT QË NDRIQON FUQISHËM NË FLAKËN E JANARIT



Ismet SYLEJMANI

Të nderuar të pranishëm!

Sot është hera e dytë në jetën time që mbaj fjalim në Kamenicë!

Herën e parë në Kamenicë, kam mbajtur fjalim lamtumirës në shtator të vitit 1999, në emër të Shtabit të Zonës Operative të Karadakut, në rivarrimin e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Para disa ditësh në Gjilan, më 17 Janar, në një tubimin të thirrur nga Shoqëria LËVIZJA, pata një fjalë rasti dhe në mes tjerash, në fillim të fjalës time deklarova se Anamorava jonë e dashur, e cila për m2 (metër katror), kishte më shumë se çdo pjesë tjetër Kosovës, figura e personalitete të mëdha kombëtare, të cilët e dominonin skenën politiko-patriotike ilegale në Kosovë e vise dhe kishin ndikim edhe në Shqipëri dhe jashtë Atdheut e kudo nëpër kontinente të botës!

Por sot këtu para juve të nderuar të pranishëm, atij konstatimi timit në Gjilan, me knaqësi e solemnisht mund t'i shtoj, që në fakt edhe është e vërteta, se Kamenica e dominon katecipërisht këtë, sepse nga ky vend e kanë vendlindjen të mëdhenjtë e të mëdhenjëve të pavdekshëm, udhëheqësit e luftëtarët titanë

të Atdheut, Heronjtë e Kombit, Metush Krasniqi, Rexhep Malaj, Kadri Zeka, Nuhi Berisha dhe Isa Kastrati, të cilët përbëjnë 5-shën e famshme, e cila është kurora e olimpit shqiptar të epërsisë kuantitative dhe kualitative me pjesët tjera të bijëve e lindjeve të mëdha të truallit tonë!

Në shtratin e lavdishëm të historisë për liri, çlirim e pavarësi të Atdheut, krahina e Kamenicës, krenohet e mburret me atdhetarët e patriotët e gjallë, ata që në çdo çast e në çdo rast ishin në gjendje të shkriheshin për Atdhe e që vuajtën dhe u dergjen burgjeve të pushtuesit, e të tillët janë, disa po i përmendi me emra: Emin Krasniqi, Skender Kastrati, Hasan Dermaku, Nijazi Korça, Sali Malaj, Begzad Sinani, Ali Hoxha, Sadri Sherifi, Shefik Sadiku e shumë, e shumë të tjerë,...

Kamenica me fshatrat e sajë, duke qenë pjesa e fundit e Kosovës në kufi me Serbinë pushtuese, ani pse edhe ai kufi ishte dhe mbetet në dy anët me tokat shqiptare, përbënte hallkën më të jashtëzakonshme të luftës për liri e çlirim nga pushtuesit serb, sepse lidhte në dy pjesët tokat e pushtuara nga i njëjti pushtues në Kosovë dhe në Serbi, qe e kishin obrelle

Jugosllavinë!

Të dashur vëllezër e motra,

Këshilli i Rrethit të Lëvizjes Popullore të Kosovës -LPK, që përbëhej nga Kamenica, Gjilani dhe Vitia, më 11 Janar 1991, në një aksion të organizuar ilegal, në këto tri rrethe i ka shpërndarë 3000 FTESA në emër të Lëvizjes Popullore të Kosovës - LPK, për homazhe në varrezat e qytetit në Gjilan, te varret e Heronjëve të Kombit Rexhep Malaj e Nuhi Berisha, në përvjetorin e 7-të rënies së Tyre!

Këtu në këtë datë e në këtë aksion ilegal politiko-patriotik në tërë Anamoravën, nisi flaka e janarit, e cila u rrit e u zgjerua, morri përmasa të mëdha e uroj të mos shuhet kurrë, të ndriqojë çdo skutë të Atdheut, e të shkëlqejë me vepra të mëdha e suksese të ndryshme në shërbim të Kombit!

Në themelet e flakës së janarit që ka filluar dhe është shpërndarë edhe në këtë pjesë të Atdheut, krahas Gjilanit e Vitisë, edhe Kamenica e ka pasur në udhëheqje të lartë të Lëvizjes në Këshillin e Rrethit të Anamoravës, pjestarin e sajë dhe ai është Irfan Musmurati!

Të nderuar të pranishëm,

Duhet të jemi përgjithmonë të

lumtur e të nderuar, që Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, i hodhi lëndën e saj shekullore, flakës së kuqe të Janarit, kur kurorëzoi me sukses aspiratat dhe ëndrrat e qindra dhe mijëra heronjëve, të të parëve tanë, baballarëve e nënave, motrave e vëllezërve, atëherë kur më 17 Nëntor 1994, kur themeloi të levdishmen, heroiken, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, arkitekten e çlirimit të Kosovës nga Serbia pushtuese!

Por, pas përfundimit të luftës së UÇK-së, dhe pas çlirimit më 12 Qershor 1999 të Kosovës nga Serbia pushtuese, e cila u ndihmua nga NATO dhe nga aleati ynë i madh Shtetet e Bashkuara të Amerikës-SHBA, furnizuesja me e madhe e flakës së Janarit Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, nuk e ndali aktivitetin e saj!

Ashtu sikur duhet ta dijmë të gjithë, Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, në vitin 2000 themeloi Ushtrinë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc - UÇPMB-në, e cila, përmes Përfaqësuesit të saj Politik, Heroit të Kombit e të Luginës së Preshevës, të pavdekshmit Jonuz Musliu, më 26 Janar të vitit 2000, e bëri publike fillimin e luftës së armatosur, e cila bëri luftë të madhe, ku u derdh gjak dhe u

ngrit në një stad tjetër gjendja e rëndë e popullit shqiptar në trojet e veta stërgjyshore në Luginë të Preshevës!

Flaka e luftës për liri e çlirim, morri flakë edhe më shumë e u bë edhe më e madhe, atëherë kur Lëvizja Popullore e Kosovës - LPK, në vitin 2001 themeloi Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoninë e Veriut, e cila jo vetëm bëri luftë heroike e çlirimtare të sukseshme, por e përfundoi luftën me Marrveshjen e Ohrit, dhe ashtu sikur e dimë të gjithë, e bëri edhe de jure zot të fateve të veta popullin shqiptar në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë!

Flaka e janarit do të mbetet flakadan i madh, e nuk do të ketë asgjë tinzare e antikombëtare që do ta shuajë, sepse ajo e ka zanafillen te nderimi i Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit dhe ushqehet nga gjaku i të rënëve për liri e pavarësi!

KAMENICA ËSHTË NJË SKAJ I LARGËT I ATDHEUT QË NDRIQON FUQISHËM NË FLAKËN E MADHE TË JANARIT

Lavdi të rënëve për liri!

Prishtinë, 27 Janar 2023

Tragjedia shekspiriane e mbretit Çarls dhe e djemve të tij inatçorë



Nga Sean O'GRADY

Sikurse i tha gazetari i ITV, Tom Bradbi, Princit Herri gjatë asaj që ishte intervista mbretërore më e dhimbshme që kur Diana dha një intervistë për Martin Bashir duke treguar se në martesën e saj kishte pasur 3 persona, tek tragjedia e djalit "rezervë" ka një nuancë të caktuar shekspiriane. Vetë emri i princit, i frymëzuar nga Henri V, dhe nga titulli i tij zyrtar i Henri i Uellsit, mbart një atmosferë antike, dhe duket sikur në provincën e Helmandit në Afganistan oficeri i tij komandues therët më të lartë: O Zot ki mëshirë për Herrin, Anglinë dhe Shën Xhorxhin!" përpara nisjes së helikopterëve të luftës në një mision kundër talebanëve. Të metat në personalitetin e tij, disa (pa dyshim) të shkaktuara nga ajo që ai e quan "lëndimnga stresi post-traumatik" pas vdekjes së nënës së tij, janë shumë reale. E tillë ishte edhe tragjedia e vetë Dianës. Sipas fjalëve mbresëlënëse të vëllait të saj, Çarlsit, Erli i Spenser, në

eulogjinë e tij në Ëestminster Abbey "nga të gjitha ironitë për Dianën, ndoshta më e madhja ishte kjo: një vajzë që iu dha emri i Perëndeshës së lashtë të gjuetisë ishte në fund personi më i gjuajtur i epokës moderne". E gjitha kjo, dhe pse thelbësore për tragjedinë, është një prolog. Herri i tha me shaka Bradbitse nuk e njihite shumë Shekspirin, por babai i tij po. Ndaj shumëkush duhet të pyesë veten nëse Çarlsi ndan diçka të përbashkët me mbretin Lir në tragjedinë e Shekspirin. Ashtu si Mbreti Lir, një drame e bazuar tek një mbret ti moshuar mitik të Britanisë, dhe 3 vajzat e tij Goneril, Regan dhe Kordelia, Çarlsi kërkoi nga pasardhësit e tij dashurinë, besnikërinë dhe respektin e tyre. Në dramën shekspiriane, ashtu si në jetën reale, do të kishte zhgënjim. Në funeralin e Princit Filip, njeriu i jetës për Elizabetën – një Çarls 72-vjeçar qëndroi mes dy djemve të tij, dukshëm më të shtatlartë dhe më i fuqishëm se ai, duke parë "fytyrat e skuqura" dhe iu lutur atyre: "Mos i bëni një mjerim vitet e mia të fundit!".

Por Herri nuk i kushtoi vëmendje asaj fjalie. Siç thotë mbreti Lir tek drama "Shumë më e dhimbshme se sa dhëmbi i gjarprit, është të kesh një fëmijë mosmirënjohës!". Ne e dimë shumë mirë historinë e asaj që do të pasonte. Gjithsesi ka një simetri me historinë e sotme, e cila mund të frymëzojë një dramaturg përstrukturën e një drame. Kështu, tradhtitë e dikurshme të Çarlsit ndaj nënës së tyre dhe të djemve, janë pasuar sot nga tradhtia e ndërsjellë e Harrit kundër Çarlsit dhe Uilliamit, dhe nga tradhtia e Uilliamit që nëfund u përkrah nga Çarlsi, dhe nga pozicionimi i Kamilës kundër kujtimit të Dianës (tani e rimishëruar si Megan Markëll, të paktën në imagjinatën e trazuar të Herrit). Prandaj në këtë rast, po shohim një armiqësi me nuanca shekspiriane. Ose një shpagim, siç mund të themi sot. Shembulli që ka dhënë vetë Çarlsi dikur, atë që disa do ta quajnë "egoizëm" kundër gruas së tij të parë, ka bërë sot që djemtë e tij të jenë shumë të

fortë, madje njëri prej tyre është mjaftueshëm i vendosur për të siguruar atë që Herri e quan "llogaridhënie", një term elegant për termin hakmarrje. Sipas thënies së famshme të Shekspirin, Çarlsi mund ta konsiderojë veten "më shumë një njeri ndaj të cilit mëkatohet se sa mëkaton". Por ashtu si Mbreti Lir, ne e dimë se monarku ynë ka gjithashtu një temperament të keq. Në fakt, nxiti përdorimin e dhunës verbale (tek Herri) dhe fizike (Uilliami). Edhe kjo duket të jetë një temë tjetër e dramës së Shekspirin, referuar sjelljeve jo aq moderne të familjes mbretërore Uindsor. Tradhtia lind tradhtinë. Në botën e Tudor-ëve, rivalitetet midis tyre do të ishin zgjidhur me forcën e armëve. Sa për të përdorur titujt e tyre shekspirianë, Herri, Duka i Sussexit, e sheh veten të tradhtuar nga babai i tij, dikur Duka i Kornuollit (që tek Mbreti Lir është çuditërisht burri i Regan) dhe vëllai i tij është Duka i Kembrixhit. Siç sugjeroi një postim në

Twitter, ndoshta Herri duhet të kishte mbledhur një ushtri në Sussex dhe të nisej për të luftuar kundër vëllait të tij, që do të udhëhiqte forcat e tij nga Kembrixhi. Ka shumë pikëllim dhe hidhërim në historinë e rënies së përshpejtuar të Shtëpisë Uindsor pas vdekjes së Mbretëreshës dhe bashkëshortit së saj. Ishte diçka që nuk pritej, por edhe kjo distancë relativisht e shkurtër nga fundi i mbretërimit të Elizabetës II, ne mund të shohim tani se sa me rëndësi ishte ajo në raport me integritetin einstitucionit të monarkisë, dhe sa i zvogëluar është bërë tani ai. Kurora britanike nuk është gati të bjerë, por ka shumë sinjale mbi këtë fund fatal, si dhe përçarje por edhe luftëra kulturore. Siç thuhet tk drama e Shekspirin: "Dashuria ftohet, miqësia bie, vëllezërit ndahen; në qytete ziejnë kryengritjet; në fshatra ka mosmarrëveshje; në pallate gëlojnë tradhtitë dhe prishet lidhja midis djalit dhe babait". / "The Independent" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Mba kalon nga Trepça '89 te Partizani

TIRANË, 29 JANAR - Partizani ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit Christian Mba nga Trepça '89. 23-vjeçari nga Nigeria ka nënshkruar kontratë trevjeçare me klubin nga kryeqyteti shqiptar. Lajmi

është bërë i ditur nga faqja zyrtare e klubit shqiptar në rrjetet sociale përmes një video. "FK Partizani me kënaqësi zyrtarizon afrimin e Christian Mba. Klubi ka arritur akordin me sulmuesin, i cili së

fundmi ishte pjesë e ekipit Trepça '89", thuhet në njoftimin e Partizanit. Christian Mba iu bashkua skuadrës nga "Riza Lushta" në Mitrovicë në janar të vitit 2022. Mba këtë edicion ka realizuar

10 gola me fanellën e Trepçës '89 në elitën e futbollit kosovar, vetëm një më pak se dyshja e Dritës, Besnik Krasniqi dhe Marko Simonovski që ndajnë pozitën e parë.



Prishtina arrin fitore të lehtë ndaj Rahovecit, Ylli bie pas 15 ndeshjeve në Mitrovicë

PRISHTINË, 29 JANAR - Sigal Prishtina ka shënuar fitore të lehtë në udhëtim te Rahoveci me rezultat 48:82 (8:24, 14:18, 8:25, 18:15), në xhiron e 20-të të Prince Caffè Superligës. Prishtinasit ishin më të mirë në këtë ndeshje nga fillimi deri në fund për të shënuar fitore të merituar. Mysafirët e nisën sfidën më mirë dhe çerekun e parë e fituan bindshëm 8:24. Lojë më e barabartë u zhvillua në periudhën e dytë, por sidoqoftë, loja u kontrollua nga mysafirët, duke shkuar në pushim me rezultat 22:42. Prishtinasit e nisën furishëm periodën e tretë, që e fituan edhe më bindshëm 8:25, ndërsa në dhjetë minutat e fundit nuk kishte ndonjë ndryshim dhe Prishtina fitoi 48:82. Edmond Kryeziu shënoi 11 pikë te vendasit, kurse Brooks Debischop kishte 12 pikë e dhjetë



kërcime për mysafirët. "Vreshtarët" mbeten në vendin e fundit me dy fitore e 18 humbje, kurse prishtinasit kanë 15 fitore e pesë humbje, aq sa ka edhe Golden Eagle Ylli. Në një super ndeshje dhe dramatike, Trepça ka

mundur kampionin Golden Eagle Yllin me rezultat 69:67 (20:14, 21:21, 12:16, 16:16), në javën e 20-të të Prince Caffè Superligës. Kjo ishte humbja e parë për Yllin pas 15 fitoreve radhazi, ku kanë edhe pesë

humbje, ndërsa mitrovicasit kanë 11 fitore e nëntë humbje. Vendasit e nisën për mrekulli ndeshje me një seri fantastike 13:1, por mysafirët dalëngadalë u rikthyen, ku çereku i parë përfundoi 20:14. "Xehetarët"

sërish e nisën vullshëm periudhën e dytë, duke qenë disa herë në epërsi deri në 16 pikë, por therandasit sërish u rikthyen për tu mos u dorëzuar dhe pjesa e parë përfundon 41:36. Perioda e tretë ishte më e barabartë, ku rezultati ishte i ngushtë dhe asnjëra skuadër nuk arrinte shkëputjen, derisa pas 30 minutash rezultati në semafor ishte 53:51. Kjo bëri që dhjetë minutat e fundit të jetë vendimtar në këtë sfidë. Luftë e madhe u zhvillua në parket me dëshirën e madhe për fitore, megjithatë në momentet vendimtare, Trepça ishte më e vëmendshme dhe fitoi 69:67, kurse gjuajtja e Rashun Davis të Yllit nuk ishte e saktë në sekondën e fundit. Më i miri ishte te vendasit ishte Andrew Gordon me 22 pikë e gjashtë kërcime, kurse Davis i mysafirëve shënoi 20 pikë.

Loriana fiton medaljen e bronzë në Portugali

Prishtinë, 29 janar - Medalja e bronzë e Lorianës, Kuka: Xhudo e nisi vitin mbarë, shpresojmë të vazhdojmë kështu Xhudistja Loriana Kuka e ka fituar medaljen e bronzë në Grand Prixin e Portugalisë. Loriana për medaljen e bronzë triumfoi ndaj koreanës, Jeongyun Lee, në kategorinë deri në 78 kilogramë. Rreth suksesit të Lorinës në Portugali ka reaguar edhe trajneri kosovar i xhudos, Driton Kuka. Kuka vlerësoi Lorianën për medaljen e bronzë të fituar, ndërsa tha se xhudo me këtë medalje e nisi mbarë vitin 2023. "Grand Prix Portugali. Medalja e

radhës e Lorianës! Në një ditë me shumë luftëra të forta në fund mori medaljen e bronzë dhe pikë të reja Olimpikë. Gara e parë sivjet kualifikuese, shënoj edhe plasmanin e shkëlqyeshëm të Flakës në mesin e 8 të parave. Laura favoritja për medalje kësaj radhe u befusua dhe humbi qysh në xhiron e parë! Shpati luftoj mirë por mbeti pa plasman, ndërsa Dardan Cena u përball për herë të parë me gara të forta dhe ishte përvojë e mirë për të ardhmen e tij. Xhudo e nisi mbarë këtë vit me medalje dhe shpresojmë kështu të vazhdoj tutje", ka thënë Kuka.



Napoli triumfon në derbin ndaj Romës


Napoli, 29 janar - Napoli nuk e ka ndërmend të ndalet dhe vazhdon rrugëtimin drejt titullit kampion. Ekipi i Spalletit mundi me rezultat 2-1 Romën, duke shkuar

kështu në kuotën e 53 pikëve, në vendin e parë. Minuta e 17-të do sillte një nga episodet më të rëndësishme të ndeshjes. Osimhen tregon klasin e tij,


atë çka jemi mësuar ta shikojmë, goditje e bukur e nigerianit e cila nuk ka fund tjetër përveç rrjetës. Asist Kvara, i konfirmuar te napoletanët. Ekipi i Jose

Mourinhos përpiqet që të reagojë dhe vendos ekuilibrat pak minuta nga fundi me italo-egjiptianin El Shaarawy. Vendasit fitojnë falë golit në fund të Simeone.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti për Burime Njerëzore

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë 04.01.2023 me nr. ref: DBN 07/01/2023, Policia e Kosovës:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIONIT


Të publikuar nga data 05.01.2023 deri me datë 26.01.2023 për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas).

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor
Vendi i punës : Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri


Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për dhjetë (10) ditë duke filluar nga data **27.01.2023** deri me datë **10.02.2023**.

Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Aplikimi bëhet në formën fizike që nënkupton se aplikacioni duhet të shkarkohet nga faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në adresën www.kosovopolic.com / Shpallje/Mundësi punësimi Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet tjera mund dërgohet fizikisht në stacionin më të afërt të Policisë ose të dërgohet përmes elektronike (email) në adresën: rekrutimi@KosovoPolice.com.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Uprava za Ljudske Izvore

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o radu br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije Br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i Odluka Generalnog Direktora od 04.01.2023 pod referentnim br: DBN 07/01/2023, Policija Kosova:

PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Objavljen od 05.01.2023 do 26.01.2023 za prijem policijskih službenika po prethodnim uslovima konkursa za sve manjine (Srbe, Bošnjake, Turaka, Goranaca, Roma, Aškalije, Egipčane, Hrvate, Crnogorce, i Makedonce).

Naziv radnog mesta: Policijski službenik
Radno mesto: Regionalna Direkcija Mitrovica -Sever

Rok za prijavu aplikacija je produžen za još deset (10) dana, počevši od **27.01.2023** do **10.02.2023**.

Pažnja: Kriterijumi na konkursu ostaju isti, i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju da se ponovo prijave .

Apliciranje se obavi na fizičkom obliku, što podrazumeva da se aplikacija mora preuzimati sa službenog sajta Policije Kosova na adresu www.kosovopolic.com / **Oglas/Mogućnosti zapošljavanja**. Popunjena aplikacija zajedno sa drugom dokumentacijom mogu se fizički proslediti na naj bliskoj Policijskoj Stanici ili da se dostave preko elektronske pošte (email) na adresu: rekrutimi@KosovoPolice.com.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ndërmarrja e Re IBG Industria e Baterive Gjilan SH.P.K. shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me nr. Unik Identifikues 810813156 bënë shpallje në gazet për zvogëlimin e kapitalit nga 3,255,513,00 në zero.

- Hana Rexhaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, të UP-së, Prishtinë.

- Burhan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë.

- Dardan Pjetraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Agron Krrakaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së 10-të të shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



TrafikuUrban

Në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen në nenin 21, lidhur me nenin 17 pika 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Rregullores nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 dt.13.07.2022 dhe në bazë të vendimit nr.332 dt.27.01.2023, KA shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

- Shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- **Pozita e punës:** Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm
- **I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit
- **Kohëzgjatja e punës:** 3 vite
- **Niveli i Pagës:** II.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat d,f,k dhe l të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatit duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në: Ekonomik, Juridik, Administratë Publike, Financa Publike apo fusha të tjera të studimeve relevante;
- Certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave.
- Kontabilist i Certifikuar e preferueshme;
- Përvojë pune profesionale 3 vite e preferueshme në Auditim dhe Kontabilitet;
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të jetë objektiv dhe i paanshëm;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi me theks të veçantë Ligjin për NP dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;
- Aftësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes së aktiviteteve të Auditimit;
- Aftësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e ndërmarrjes;
- Aftësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

1. Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban në zarfë të mbyllur:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
- Një CV të detajuar;
- Dëshmi mbi shkollimi, kopjet e diplomave mbi kualifikimin, diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimin;
- Kopje të certifikatave;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Deklaratën nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mund të shkarkohet nga ueb faqja e ndërmarrjes;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material i nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban.

Konkursi është i hapur nga data **30.01.2023** dhe përfundon më datë **13.01.2023** në ora **16:00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 30.01.2023

2

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



TrafikuUrban

Na osnovu funkcija i ovlašćenja predviđenih članom 21, u vezi sa članom 17 tačka 17.1 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, Zakon br.04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Uredba br. 01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta sa br. 1827 od 13.07.2022.godine i na osnovu rešenja broj 332 od 27.01.2023.godine, KR je objavio:

JAVNI KONKURS

- Javni konkurs se raspisuje na određeno vreme za radno mesto u preduzeću i to:
- **Radno mesto:** Službenik za Unutrašnju Reviziju
- **Odgovara:** Komitetu za Reviziju
- **Trajanje rada:** 3 godine
- **Nivo plata:** II.

Zahtevi i potrebne kvalifikacije:

Komisija za reviziju želi da osigura da su svi kandidati lica visokog integriteta koja ispunjavaju kvalifikaciju uslove prema članu 17.1, kao i da ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2 tačke d, f, k i l Zakona o javnim preduzećima i da imaju potrebno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetno radno mesto. Pored ovih opštih uslova, kandidat mora imati:

- Univerzitetska diploma iz: ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti studija;
 - Sertifikat internog revizora u javnom sektoru, izdat od strane Ministarstva finansija ili sertifikat za internog revizora u javnom sektoru od bilo koje relevantne međunarodne ili domaće institucije u skladu sa kriterijumima koje izdaje ministar finansija.
- Poželjno je sertifikovani računovođa;
- Profesionalno radno iskustvo u računovodstvu najmanje 3 godine;
- Da budi objektiv i nepristrasan;
- Dobro poznavanje zakona i propisa na snazi sa posebnim akcentom na Zakon o JP i druge zakone koji se odnose na unutrašnju kontrolu i finansijsko upravljanje;
- Veštine komunikacije, planiranja rada i vođenja aktivnosti revizije;
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost saradnje sa menadžmentom i osobljem kompanije;
- Sposobnost delegiranja i praćenja ovlašćenja i odgovornosti saradnicima za obavljanje delegiranih funkcija;
- Napredna znanja u korišćenju informacionih tehnologija i standardnih softverskih paketa;
- Poznavanje engleskog jezika se smatra prednošću.

Dužnosti i odgovornosti:

- Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.

Potrebna dokumentacija:

Kandidat je dužan da dostavi ova dokumenta u fizičkom obliku kancelarijama za "Trafiku Urban" u zatvorenoj koverti:

- Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://vww.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacioni-shk.html>;
- Detaljan CV;
- Dokaz o obrazovanju, kopije diploma o kvalifikaciju, diplome stečene u inostranstvu moraju biti ovjerene;
- Kopija lične karte;
- Motivacija pismo;
- Kopije sertifikata;
- Dokaz o dokazanom radnom iskustvu u Trustu
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa sajta kompanije;
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;

Opšte informacije:

– Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primene:

Prijava se može podneti samo u fizičkom obliku u kancelarijama "Trafiku Urban".

Konkurs je otvoren od **30.01.2023** i završava se **13.01.2023** u **16:00** časova.

Napomena: Nepotpuni dokumenta i onih koja pristignu nakon konkursnog roka neće biti pregledane.

Datum: 30.01.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues